

INTERVISTË ME BERAT LUZHËN

Prishtinë | Data: 9 dhe 14 qershor, 2022

Kohëzgjatja: 130 minuta

Të pranishëm:

- Berat Luzha (I intervistuari)
- Anita Susuri (Intervistuesja)
- Renea Begolli (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Nëse mundeni me u prezantu? Me na tregu për vitin e lindjes, vendin e lindjes edhe diçka për prejardhjen e juj, familjen?

Berat Luzha: Jam Berat Luzha. Vij nga fshati Begracë komuna e Kaçanikut. Jam i lindur me 8 janar të vitit 1953. Shkollimin fillor e kam kryer në fshatin tim katër klasë. Katër klasë të larta në Kaçanikun e Vjetër, ni fshat afër. Pastaj gjimnazin në Kaçanik dhe fakultetin në Prishtinë, [Gjuhë dhe] Letërsinë Shqipe. Fëmënia ime ka qenë si e të gjithëve, mjaft e vështirë për shkak të gjendjes ekonomike të familjeve tona. Familja ime ka qenë e mesme, ndoshta, mund të themi për atë kohë. Mirëpo, të gjithë kanë qenë të varfër dhe fëmëtitë kanë qenë jashtëzakonisht të pa... pakujdesshëm. Nuk kanë pasë kujdesin e mjaftueshëm dhe si të them, nuk kam jetuar ni jetë tamon normale.

Anita Susuri: Me çka u marrë, për shembull baba juj?

Berat Luzha: Po, baba edhe nana kanë qenë të pashkolluar, sigurisht, kanë qenë analfabetë. Babai im ka ditë vetëm emrin e vet me shkruar, jo ma shumë, edhe ata e ka mësuar në ushtri. Mirëpo, baba ka qenë ni person i respektueshëm mjaft shumë, i njohur në anën tonë, është marrë edhe me pajtimin e gjaqeve. Ne kemi pasë edhe ni odë të vjetër, odë tradicionale shqiptare. Ai ka qenë mikpritës i shumë mysafirëve që atëherë kanë hyrë e kanë dalë në atë odë.

Oda ka qenë pothuajse çdo ditë me mysafirë dhe baba ka qenë një zot shtëpie që ka pasë emër. Ka pasë emër për mençuri e urtësi. Nana ka qenë si të gjitha nanat e tjera, amvise sigurisht. Me vujtje të mdhaja, me punë shumë. Ka qenë e dallume për urtësinë e saj, për kujdesin ndaj fëmëve sigurisht dhe vujtje të pakufijshme.

Anita Susuri: Po më intereson këto bisedat që po i thoni nëpër oda, a kanë qenë edhe biseda për, si me thanë, për pozitën e shqiptarëve, për vujtjen e shqiptarëve në sistem, apo kanë qenë diçka herët me u diskutu? Apo kanë bo kujdes?

Berat Luzha: Shqiptartë asniherë nuk i kanë llogaritë institucionet e shtetit si të vetat dhe të gjithë veprimtarinë e tyre e kanë përqendruar nëpër oda, qoftë pajtimin e gjaqeve, qoftë martesat, fejesat. Pastaj ritet e vdekjes, të gjitha në odë dhe në këtë mënyrë aty janë zhvilluar. Janë zhvilluar edhe melosi popullore, për shembull. Janë zhvilluar edhe këto anekdota të ndryshme. Ka pasë lojëra të ndryshme që janë luajtur. Pastaj, si, kur janë mbledhë mysafirtë, kur kanë ardhë mysafirë janë mbledhë shumë njerëz osht' mush oda plot.

Aty ka pasë biseda të ndryshme edhe politike herë pas here, por edhe për jetesën e atëhershme edhe për plane se çka me bo, si me ia bo punës, për atë, për këtë, për probleme të ndryshme. Oda në nifare mënyrë i ka zëvendësuar institucionet e shtetit. Madje, kjo oda ime kaniherë ka shërby edhe si objekt fetar për shkak se njerëzit për mos me shku larg në xhami, janë ndalë aty i kanë bo ritet. Sidomos kur ka pasë mysafirë ndonjë hoxhë në odë atëherë janë ba aty, janë thirrë ezan e të tjera.

Anita Susuri: A keni jetu në atë kohë me familjen në bashkësi? Për shembull, me axhallartë?

Berat Luzha: Po, po. Deri, diku në moshën 12-13 vjeçare kemi qenë në bashkësi edhe me mixhën edhe me kushërinin. Mirëpo, ma vonë jemi nda edhe ndamjet kanë shku seri [në mënyrë serike]. Kështu që, tashma nuk jemi ni familje me shumë tokë e me shumë pasuri, për shkak se pasuria është coptu dhe është nda shumë herë edhe kështu.

Anita Susuri: A osht' marrë familja me bujqësi, blegtori?

Berat Luzha: Po, po, bujqësi, blegtori. Kryesisht blegtorja me lopë, me bullica, me dhenë edhe bujqësia me grunë edhe misër kryesisht.

Anita Susuri: E përmendët për, folët për babën e juj edhe për ushtrinë, çfarë gjenerate ka qenë baba juj?

Berat Luzha: Baba ka qenë i lindur në vitin 1915, ka jetu 80 vjet rrafsh.

Anita Susuri: A ka qenë atëherë në ushtrinë e Mbretërisë Jugosllave?

Berat Luzha: Po, të Mbretërisë Jugosllave dhe jo niherë, por ka qenë tri herë. Niherë ka qenë shërbimin e rregullt ushtarak dhe dy herë ka qenë pastaj në ushtrime i kanë qujtë atëherë, *vezba* [Srb.: ushtrime]. I kanë marrë për me i përgatitë për luftë. Por, fati i tij që Lufta e Dytë Botërore kur ka fillu me u prishë Jugosllavia është tërënjë prej ushtrisë ka ardhë në shpi dhe nuk ka marrë pjesë në luftë. Mixha edhe kushërinin janë mobilizuar. Njëni ka shkue në Banat si i mobilizim, tjetri ka shku nga Tivari, ju e dini rastin e Tivarit. Edhe për fat nuk kanë pasë fatkeqësi për, për...

Anita Susuri: A ka qenë në kohën e masakrave kur ka ndodhë, të Tivarit?

Berat Luzha: Po, kushëri ka qenë. Po kanë shkue, kjo grupa ka shku pak ma vonë pasi është kry masakra, domethonë edhe kta nuk i kanë masakru.

Anita Susuri: Po a ju kujtohet ndonjë tregim i tij? Qysh e kanë marrë vesh ose çka...

Berat Luzha: Po, po. Ata i kanë pa t'u e pastru terenin, t'u e pastru gjakun. Ato çka kanë pasë, rrobat që kanë qenë të shkapërderdhura, por jo kufomat. Po kanë marrë vesh pastaj që kufomat i kanë hudh, shumicën e tyre i kanë hudh në det. Se Tivari është qytet bregdetar.

Anita Susuri: Po. E baba ju j çka tregon për atë kohën e ushtrisë? Qysh ka qenë në atë kohë?

Berat Luzha: Atëherë ushtria ka qenë shumë e randë. Oficerët kanë pasë të drejtë me rrah ushtarin në çdo moment edhe sidomos shqiptartë janë trajtu keq. Prej atëherë, prej 1912-ës por kanë vazhdu deri në luftën e fundit të UÇK-së. Ata ushtarë, ni pjesë nuk janë kthy fare në shpi po kështu ka qenë. Ksëhtu ka qenë për shkak se shqiptarëve asniherë serbët nuk iu kanë besue edhe i kanë llogaritë si mish të hujin në trupin e tyre.

Anita Susuri: E ju në familje, prindërit e ju j, sa fmi i... sa vllazër e motra keni pasë?

Berat Luzha: Po, unë kam pasë dy motra që tash nuk janë në jetë edhe ni vlla që osht' gjallë, ma i vjetër se unë. Kom pasë edhe ni motër që ajo ka vdekë prej fruthit në moshën tre-katër vjeçe. Këto kanë qenë.

Anita Susuri: Ju po i bjen, diku në vitet '60-ta shkollën e mesme kur e keni vazhdu, sa po i bjen afërsisht, tash s'po e di, ndoshta afër '68-ës ka qenë?

Berat Luzha: Po, në '68-ën e kom regjistru shkollën e mesme, gjimnazin.

Anita Susuri: Atëherë kanë qenë edhe demonstratat e vitit '68?

Berat Luzha: '68.

Anita Susuri: A ju kujtohet?

Berat Luzha: Na kemi dëgjue, por kemi qenë shumë të ri atëherë. Nuk kemi mujtë me marrë pjesë apo nuk kemi pasë qartësi sa duhet për krejt ato. Diku kam qenë 14-15 vjet, nuk e di. Por që kanë pasë jehonë sigurisht te nxënësit. Prej atëherë ka fillue, me nifarë mënyre ni ngritje e ndjenjave kombëtare.

Anita Susuri: E ju thatë që keni vazhdu shkollën e mesme në Kaçanik, po pastaj keni vazhdu në Prishtinë...

Berat Luzha: Po.

Anita Susuri: Qysh ka qenë ky transferim me ardhë prej ni vendi ma të vogël në Prishtinë në ato vite?

Berat Luzha: Së pari atëherë nuk është shkollu secili si shkollohen sot, sidomos vajzat pothuajse fare. Kurse edhe djemtë pak. Prej fshatit tim në gjimnaz kemi qenë vetëm tre në gjeneratë, se atëherë nuk iu ka dhanë rëndësi shumë e madhe shkollimit. Fëmijtë kanë qenë të angazhum në punë bujqësore, punë blegtorale e tjera. Kështu që, shumica e nxanësve që e kanë kry klasën e tetë nuk kanë vazhdu shkollën e mesme. Por pastaj, pas shkollës së mesme, sigurisht ata që e kanë kry shkollën e mesme, ni pjesë e madhe kanë vazhdue fakultetin.

Atëherë edhe universiteti ka qenë me pak studentë, jo sikur sot që ka shumë. Kom pasë regjistruar teknologjinë në fillim si degë. Pata arritë ta jap provimin pranues, u regjistrova, vijova dy vjet po kisha problem se nuk isha i përgatitun shumë për lëndët ekzakte, për lëndët teknike, sidomos matematikë. M'u mush mendja që s'do të mund ta japë provimin e matematikës asniherë. Kështu që e ndrrrova fakultetin kalova në Letërsi edhe Gjuhë Shqipe, Fakultet atëherë Filozofik është kujtë.

Anita Susuri: E qysh ka qenë Prishtina në atë kohë? Ku keni banu, për shembull? Qysh jeni gjetë në Prishtinë?

Berat Luzha: Jemi gjetë si kemi mundur në banesa private kryesisht. Edhe atëherë ka pasë problem se s'ka pasë shumë [hapësirë në] konvikte. S'di kanë qenë dy konvikte apo tri ma s'shumti, nuk ka pasë. Unë nuk kam mund të regjistrohem në konvikt.

Anita Susuri: Kanë qenë edhe si do baraka diçka?

Berat Luzha: Kanë qenë edhe disa baraka në oborr të konvikteve po me kapacitet të vogël edhe ato. Kështu që, unë nuk kam mund të banoj në konvikte.

Anita Susuri: Qysh ka qenë Prishtina, për shembull? Si ju kujtohet Prishtina e asaj kohe?

Berat Luzha: Ka ndryshue shumë, ka qenë shumë ma ndryshe. T'u fillue prej qendrës atje, ka qenë rruga kryesore ajo edhe në mramje është zhvillu korzo që sot nuk zhvillohet është interesant. Çdo mramje ka pasë korzo, shëtitje në mramje, domethonë në rresht. Nga njëra anë e rrugës kanë qenë, janë shëtitë shqiptartë nga ana tjerët serbtë. Kështu.

Anita Susuri: Rrugtë, po më duket, veç rruga kryesore ka qenë e shtrume me kalldrëm këto tjerat kanë qenë me baltë?

Berat Luzha: Ndoshta jo me baltë, por kanë qenë ose me kalldrëm ose me, ka pasë edhe me asfalt po kanë qenë të ngushta, kanë qenë të ngushta jo kështu si janë sot.

Anita Susuri: A ju kujtohet, për shembull çfarë ndërtime janë bo në qat' kohë kur keni ardhë ju?

Berat Luzha: Po, si, po, si. Për shembull, Hotel Grandi atëherë nuk ka qenë. E mbaj mend ka qenë ni librari ku shkojshim blejshim libra. Pastaj, kjo qendra nuk ka ndryshu shumë, tash që është Bulevardi “Nënë Tereza” po ka qenë rrugë e ngushtë atëherë. Përndryshe, atëherë s’ka ekzistuar kjo Lagja Dardania fare, ka qenë vetëm si lagje e urbanizime ka qenë Ulpiana. Ulpiana edhe kjo lagja që u ndërtonte atëherë, Aktashi. U ndërtonte kryesisht prej njerëzve që atëherë ishin nëpër funksione të larta dhe u ndërtoshin me kredia. Merrshin kredi dhe i lashin me kredi. Ka qenë atëherë shtëpia shumë luksoze për atë kohë. Sot pothuajse ka ndryshu faqja e atyre lagjeve ose Lagjja Pejton që është ndërtu në atë kohë, kanë qenë shtëpi krejt të ulta, të një mase. Sot janë krejt ndryshe.

Anita Susuri: Po më intereson se në atë kohë shpesh kështu hasim në tregime që ka qenë e zhvillime jeta kulturore, teatroja, kinematë, kjo “Vllaznimi”, “Rinia”. A i keni vizitu ju?

Berat Luzha: Po, dy kinematë. Dy kinema kanë qenë. Herë pas here po. Teatrin po. Atëherë ma shumë e kam vizitu sesa tash që e vizitoj. Atëherë kanë pasë tema të rëndësishme edhe teatri sidomos, sidomos teatri ka qenë shumë i popullarizim. Studentët, ni pjesë e mirë e kanë vizitu teatrin rregullisht. Kurse edhe kinematë janë vizitu, por kur kanë ardhë ndonjë film i mirë. Sidomos kur kanë ardhë prej Shqipërisë atëherë nuk i ka zanë salla, për shkak se interesimi ka qenë shumë i madh. Shqipëria atëherë kishte ni ndikim shumë të madh te rinia e Kosovës.

Atëherë në vitet e ‘70-ta sidomos patën nisë me ardhë edhe ansamble folklorike, ansamble muzikore, ekspozita të artit, figurativ dhe interesimi ka qenë në kulm, shumë i madh, shumë i madh. Ka pasë edhe më kujtohet, ka qenë ni kampionat i basketbollit, i volejbollit është zhvillu në sallën “1 Tetori” që është tash. Kampionat Ballkanik i Volejbollit. [Aty] Ka qenë edhe ekipi nga Tirana. Është, na thojmë, është kallë atmosfera. Aq shumë, aq shumë e kanë brohoritë e kanë simpatizue Shqipërinë si ekip. Jo për shkak të lojës, por për shkak se osht’ nga Shqipëria.

Anita Susuri: A ju kujtohet, për shembull naj përjetim i veçantë kur kanë ardhë filmat ose kur jeni organizu me shku me i kqyrë këto filma ose këto ansamble që kanë pasë shfaqje?

Berat Luzha: Po tregoj, ka qenë ni delegacion i veteranëve të arsimit nga Shqipëria në Kosovë. Unë atëherë isha korespondent i gazetës “Rilindja” në Ferizaj. Shkova që ta përcjelli si veprimtari, si, thjeshtë për me përcjellë për gazetë. Përcjella krejt kur shkun në Ferizaj edhe në Kaçanik. Në Kaçanik e

ndava ni artiste, ishte e vjetër. Artiste po që kishte shërbye në Kosovë si mësuese në '45- '46, e ardhun ktu. E bona ni intervistë me të.

Mas pak kohe tani më ka marrë në pyetje se, “Çka ke bisedu ti me atë, pse ke bisedu, kush ishte ai që ishte afër teje, prej andej, e tjera e tjera”. E këtë fakt pastaj ma kanë përmend pastaj edhe në burg mas tri-katër vjete që kam shku në burg, “Se ti ke pasë ni lidhje me atë”. Kështu. Ishte pak e rrezikshme me komunikue me ansamblet e Shqipnisë që vinin në Kosovë.

Anita Susuri: E sa i përket fakultetit a keni pasë profesorë të Shqipnisë?

Berat Luzha: Jo, unë s’kam pasë, jo. Ato kanë qenë kryesisht në landët ekzakte, landët...

Anita Susuri: Gjuhë dhe Letërsi nuk ju kanë dhanë?

Berat Luzha: Jo.

Anita Susuri: A ka qenë e qëllimshme apo thjeshtë?

Berat Luzha: Jo, jo, se ka pasë kuadro ktu, nuk ka pasë nevojë. Kryesisht janë marrë ata që s’ka pasë kuadra, se vishin edhe prej Beogradit kuadra. Por edhe prej Tiranës patën ardhë ni grup i profesorëve për me dhanë mësim në landët ekzakte, fizikë, matematikë, landët teknike, e tjera.

Anita Susuri: Cili vit po bjen që e keni përfundu fakultetin? Kur keni diplomu?

Berat Luzha: Po tashti diplomimin e kam ba mas luftës...

Anita Susuri: Po mendoj...

Berat Luzha: Se me ndërprerje, me probleme se pata shku në burg, e tjera e tjera.

Anita Susuri: Domethonë në ‘76-ten ju veç keni fillu me punu në “Rilindje”?

Berat Luzha: ‘76-ten kom fillu me punue.

Anita Susuri: E qysh ka ndodhë krejt kjo? Qysh u interesutë?

Berat Luzha: “Rilindja” e kishte shpallë ni konkurs për pranimin e gazetarëve. Unë e pashë atë, atëherë isha shumë i ri nuk ma merrte mendja që unë të bohem gazetar. Se për të qenë atëherë gazetar ka qenë punë e madhe, se nuk kishte shumë media. Ishte ni gazetë e përditshme, disa revista, ishte televizioni dhe radio. Po ishin shumë të kufizumë gazetartë. Po vendosa, hajt thashë, po konkuroj. Kur

më erdh masandej ni njoftim se duhesh të paraqitesh në “Rilindje”. Shkoj në “Rilindje”, thanë, “Ti je pranë për kohë provuese dy mujore...”

Anita Susuri: Si praktikant.

Berat Luzha: Si praktikant, po. Edhe mas dy mujve kishe mundet me, mos me u pranë. Po e kreu atë, si kurs ishte ajo edhe mbetëm. Në gjeneratë ka qenë edhe [Hydajeti \[Hyseni\]](#) në gjeneratën time. Kanë qenë edhe tjerë gazetarë.

Anita Susuri: E çfarë artikuj për shembull keni shkru? Çfarë ngjarje keni përcjellë?

Berat Luzha: Atëherë, si gazetar i ri, fillestar u qujshin, kanë pasë, ma shumë janë marrë me sferën e bujqësisë. Kryesisht ka qenë nifare kombinati, “Agro-Kosova” u qunte atëherë, ni kombinat i madh që i përmbledhke të gjitha, të gjitha kombinatet ushqimore edhe bujqësore që ishin në Kosovë. Edhe ma shumë me ato, me furra të bukës ka pasë që ishin në sektor publik, jo privat atëherë. Gjitha industria ushqimore edhe kto çka ishin të sferës të bujqësisë, blegtorisë [ishin sektor publik].

Anita Susuri: E qysh ka funksionu gazeta në atë kohë? A ka pasë, tash nuk e di për bujqësi qysh ka qenë, po a ka pasë ndonjë censurë apo kontrollë për me dalë ni artikull?

Berat Luzha: Sigurisht, sigurisht që ka pasë. Sigurisht. Po ne e kemi bo vet censurën kryesisht se e kemi ditë se çka shkon edhe çka nuk shkon. Po ka pasë ndonjëherë që nuk është botu artikulli ose është kritiku në mbledhje të redaksisë ose dikë kanë pasë mundësi që me ia tërhjekë vërejtjen ose diçka, po jo shumë. Kryesisht ka pasë tolerancë në atë drejtim, jo kumeditë se sa. Po që na jemi kujdesë vet që të mos lshojmë fjalë të cilat... për të cilat mundet me pasë pasoja.

Anita Susuri: Cilat kanë qenë, për shembull fjalë ose diçka që keni ditë që mundet me pasë pasoja?

Berat Luzha: Kryesisht rreth politikës atëherëshme të Lidhjes Komuniste. Nëse diçka për Titon shkruhet, për Vllaznim-Bashkimin, tema të caktume që aty s’ka bo me prekë, ose është dashtë me shkru ashtu siç diktohet. Po unë s’kom pasë shumë kontakte me politikën, kryesisht kom qenë në ekonomi.

Anita Susuri: Po edhe ekonomia ka qenë ni temë shumë e rëndësishme se në atë kohë, u kritikojke që po ka dështim edhe në Kosovë.

Berat Luzha: Po, ka pasë, ka pasë probleme se shumica e ndërmarrjeve atëherë shkojshin me humbje.

Anita Susuri: Po. Tash po më intereson qysh ka fillu krejt kjo angazhimi juj në aktivitet? Qysh ka ardhë deri te ajo? A ka qenë para ‘81-tës?

Berat Luzha: Tashti jeta ime ka ndryshue kur kom hy në “Rilindje”. Aty kam gjetë ni kthesë të madhe e kam bo në jetë, se deri atëherë isha i papunë dhe hyna në punë. Po meniherë që hyna në punë isha në kontakt të përditshme me Hydajetin. Ai ishte i organizum në grup ilegal edhe ai filloi me më folë për gjana të ndryshme politike, andej e këndeje. Niherë si simpatizant më llogaritke, jo si anëtarë. Derisa është bindë që unë mundem me kry detyra të ilegalitetit. Pastaj më ka propozu dhe jam bo anëtar i grupit ilegal.

Atëherë është qujtë Grupi Revolucionar i Kosovës, pastaj e ndrroi emrin Grupi Marksist Leninist e pastaj Organizata Marksiste-Leniniste. Këtë atributin Marksist-Leninist ose ideologjik ma shumë e kemi bo nga shkaku i Shqipërisë që ne të jemi të njohur sa ma shumë me Shqipërinë. Për shkak se Shqipëria ishte ajo që neve na frymëzonte edhe na ndihmonte me ecë në rrugën atdhetare.

Anita Susuri: Qysh ka qenë fillimisht qajo hyrja në atë organizatë? A ka pasë ndonjë lloj, si me thanë, ndonjë lloj, tash me thonë pyetësor s’muaj me thonë se ai vet iu ka vlerësu para se me ju thirrë?

Berat Luzha: Jo, jo, pyetësor jo.

Anita Susuri: Po a ka pasë naj lloj kriteri ose diçka me plotësu?

Berat Luzha: Jo, jo. Nuk ka pasë lloj kriter kështu po gjatë bisedës të përditshme kemi trajtue tema të ndryshme dhe në atë mënyrë ka ardhë deri te përfundimi se jam i përshtatshëm dhe mundem me kry detyrat.

Anita Susuri: Po. A ka pasë organizata naj seli diku apo kanë qenë takime të mshefta?

Berat Luzha: Jo, kanë qenë takime të mshefta, takime shumë të mshefta. Grupi ynë ka qenë shumë konspirativ, ka qenë shumë i msheft. Ne kemi qenë atëherë të bindur që për shkak të veprimtarisë, aq të msheft që e bojshim, nuk mund të zbuloheshim. Mirëpo, ra ni rast ashtu edhe u zbulum si grup edhe kështu shkoi deri te burgosja jonë si grup.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: Po më interesojnë aktivitetet pak edhe si janë organizu kto?

Berat Luzha: Aktivitetet kanë qenë... gazetë ilegale, “Liria” është qujtë. Kemi shkru artikuj aty, ajo gazetë ka pasë ni shpërndarje të madhe edhe ni ndikim jashtëzakonisht të madh në rininë e atëhershme...

Anita Susuri: Kjo në vitin '80-të ka fillu me u...

Berat Luzha: Po në vitin '80-të. Pastaj, kemi shkruar parulla, kemi, kemi bo aktivitete të ndryshme kryesisht. Kryesisht në shkrimin e parullave, në lexim, jo kumeditë sa të hapun, po që ka qenë veprimtari shumë e suksesshme.

Anita Susuri: E kto parullat çfare kanë qenë edhe qysh u përcaktu ku me u shkru kto?

Berat Luzha: Kanë qenë sigurisht kundër pushtetit, kundër ndonjë veprimtarie që është mbajtur atëherë, ndonjë vizite, ta zëmë të kryetarit Tito në Kosovë, kundër parullave që atëherë u shfaqshin për Vllaznim-Bashkim, kundër armiqëve të qujtun armiq atëherë. Kemi shkruar sidomos mas '81-shës, "Kosova Republikë", apo veç, "KR", gjithkrah. Ka qenë ajo që ata e ndjekshin shumë këtë parullë edhe ne për inati e shkruajmë ma shumë. Ka pasë, ka pasë aktivitete shumë. Kemi [vepru] shumë shumë msheft, aktivitete shumë edhe sukses kemi pasë.

Anita Susuri: A ka pasë, sigurisht po, ni periudhë të caktume për sa kohë u dashtë me shkru ose në sa ora u dashtë me shkru?

Berat Luzha: Ka pasë. Nëse ka qenë e organizume me shumë persona apo në shumë vende, po. Ka qenë e organizume që të njëjtën orë në cilat vende m'u shpërnda. Ka pasë raste që kemi shpërnda edhe në qytetet në Maqedoni që janë sot, në Tetovë, në Shkup apo në Preshevë e tjerë.

Anita Susuri: Për shembull, në orët e vona janë shkru kto?

Berat Luzha: Në orët e vona sigurisht, mesnatë, pas mesnate. Në kushte që ju e keni vështirë me i kuptu se kanë qenë tepër, tepër të randa.

Anita Susuri: A mundeni me na tregu, për shembull, ni përjetim të juj kur keni shkru diçka? A ju ka ndodhë diçka që për pak ju kanë nxanë ose që jeni frikësu ose...

Berat Luzha: Jo, por ni rast, për shembull kemi qenë t'u ecë me Hydajetin bashkë edhe ni person vinte pas neve. Vinte po nuk e njifshim kush është, diku dhetë metra mrapa. Ishte natë e vonë, diku para mëngjesit. Ne hyshim në një rrugë, ai vinte në të njëjtën rrugë, ne dilshim në rrugën tjetër me qëllim që të shmangemi prej tij. Ai përsëri hynte në rrugën ku ishim ne, dikur Hydajeti tha, "Po e kapim", e kapëm, e kapëm për gjoksi edhe, "Kush je ti? Pse na ndjekë?" E kapëm çantën e tij, e kish pasë ni çantë. Hydajeti më tha, "Merre edhe kqyr çka ka në to", por nuk kish pasë ndonjë armë diçka jo. Por nuk u pahke se ish errësirë çka kishte në të. Ai u frikësu niherë, u frikësu mos po e vrasim ose diçka. Por, kur e pa që nuk po e vrasim atëherë u trimnu tha, "Hajt, haj, se keni me pa kur të del drita ju". Kështu ka pasë raste.

Ka pasë ni rast, për shembull, kom qenë t'u shku në aktivitet ilegal edhe ka qenë bjeshkë, mal i madh. Dilsha me pylltarin, shumarin që e qujshin. Ai vinte me kali, vinte përpjetë unë isha t'u zbritë teposhtë. E pashë që po vjen ai, se ishte hana që nxente edhe u shmanga që t'mos më sheh ai, se ai ishte njeri i njofshëm dhe unë s'dojsha që ai të më njeh në atë kohë që po eci, po shkoj diku. Ai ka mendu që jom ndonjë egërsinë që m'ka pa si siluetë kështu edhe ka gjujt në mu. Se ata kanë qenë të armatosur me pushkë. Ka gjujtë në mu. Unë i kom bërtitë, "Çka po qet?" "Po kush je ti?" E kështu, thashë, "S'të intereson kush jom, çka gjun ti?" E andej e këndeja ia thashë do fjalë edhe ika të mos më njeh. Kështu. Tha, "Pata me të marrë në qafë", tha, "se mendova që je një egërsinë".

Anita Susuri: Kto tekstet që i keni shkru, i keni përgatitë, kanë qenë kundër pushtetit domethonë po konkretisht çka për shembull? Për pozitën e shqiptarëve?

Berat Luzha: Për pozitën e shqiptarëve sidomos po, të Kosovës sidomos, shqiptarëve në Jugosllavi në vise tjera. Ka pasë edhe në aspektin social, për shembull pozita e punëtorëve çfare osht', pozita e ndërmarrjeve ekonomike atëherë që shkojshin vazhdimisht me humbje. Ishim kundër njerëzve që mendojshin se janë të kqi, janë anti-kombëtar në aspektin atdhetarë. Ka pasë...

Anita Susuri: E ju në grup thatë që keni qenë me Hydajetin, po a keni pasë edhe dikë tjetër në grup?

Berat Luzha: Po shumë kemi pasë.

Anita Susuri: Në celula të ndryshme apo?

Berat Luzha: Po kryesisht në celula kemi vepru, po unë kom pasë rastin tani me punu me disa nga shokët. Ni celulë e kemi pasë në Kaçanik, ktu kam qenë edhe anëtarë i Komitetit Drejtues i udhëheqësisë të grupit apo organizatës. Kam qenë me Jakup Krasniqin, me Mehmet Hajrizin e shumë shokë të tjerë.

Anita Susuri: Po më intereson, a keni, po më duket që keni pasë edhe do si fletushka ku kanë qenë do rregulla apo instruksione si me vepru...

Berat Luzha: Po, ka pasë, ka pasë.

Anita Susuri: A e dini kush i ka bo ato apo veç ju kanë ardhë në dorë kështu.

Berat Luzha: Jo, kryesisht i kemi bo vet si grup. Ato kryesisht i ka bo Hydajeti ose Mehmeti. Kta dy kanë qenë ma të përgatitun për nga ana, nga, përgatitun...

Anita Susuri: Për shkrimin e materialeve.

Berat Luzha: Për shkrimin e materialeve.

Anita Susuri: E për shembull, çfarë instruksione kanë qenë?

Berat Luzha: Po, në përgjithësi për, ka pasë rregulla se si me u sillë, si me u gjetë, si me vepru me simpatizantë, me popull, me rini si me ju ofruë, çka me folë, çka me ju ofru atyne. Ka pasë shumëçka.

Anita Susuri: E kto, për shembull, a i keni shpërnda diku? Nëpër fakultete ku ka pasë të ri apo qysh?

Berat Luzha: Jo, kto kanë qenë materiale të brendshme, vetëm të grupit.

Anita Susuri: Po, po thom kto të jashtmet, traktakti?

Berat Luzha: Traktet po, traktet i kemi shpërnda ku kemi mujtë. Jo aq shumë, nuk mund të themi që kemi shpërnda shumë, por ku kemi mujtë herë mas here. Kemi caktu vendet ku paraprakisht, kemi bo planifikimet edhe janë bo ato.

Anita Susuri: Ju thatë që ka ndodhë ni, diçka ni gabim që keni ra në durë të pushtetit, qysh ka ndodhë? Qysh ka ardhë deri te ajo ditë e burgosjes?

Berat Luzha: Po. Tashti në grupi kryesisht se ka pasë nevojë edhe për teknikë për me shkru, makina shkrimi. Po makina shkrimi nuk kanë mjaftue është dashtë me pasë shaptilograf, s'di a keni mrri çka janë ato [i drejtohet intervistuesës], po për me i shumzu materialet. Në disa raste ato janë rrëmby prej ndërmarrjeve atëherë ekonomike apo prej shkollave, janë rrëmby natën në mënyrë ilegale janë marrë. Kanë hy mrena edhe i kanë marrë edhe kanë dalë. E kanë thy derën apo diçka edhe e kanë marrë, janë furnizu. Po në një rast kur kemi pasë nevojë me pasë ni shaptilograf të mirë jemi dashtë me ble në një shitore, është qajtë, "Salloni i Librit", ku është tash Pallati i Rilindjes.

Ka qenë ni sallon shumë i mirë i librave po mbante edhe teknikë të shkrimit. Hajt po e blejmë, është ble. Mirëpo ose shitësi ose dikush aty që ka qenë në atë sallon ka qenë i lidhun me UDB-në edhe ka dyshu kush po e blen edhe pse po e blen edhe kanë përcjellë tani, e ka përcjellë. E kanë marrë ata prej atuhit për me çu në veturë, po veturën e kanë lanë larg. Ai tani i ka përcjellë, tani vetura është përcjellë në Gjilan diku atje edhe në këtë mënyrë ka shku zinxhirë deri te zbulimi i grupit.

Anita Susuri: Ju jeni burgosë në vitin '81 po më duket?

Berat Luzha: '81.

Anita Susuri: Në cilin muj?

Berat Luzha: Në dhjetor. Diku 19 dhjetor ka qenë, fundi i vitit.

Anita Susuri: Po paraprakisht në mars kanë qenë demonstratat e famshme, domethonë të studentëve.

Berat Luzha: Po.

Anita Susuri: A mundeni me na tregu krejt përvojën e juaj me demonstratat, domethonë prej 11 marsit po edhe ma herët nëse keni ditë për organizimin?

Berat Luzha: Për organizim nuk kemi ditë, megjithëse ne kemi folë se duhet të bahen, do të ketë në të ardhmen, por konkretisht nuk e kemi shtjellue se do të mbahen një datë të caktuar. Ka ndodhë 11 marsi, ma shumë ajo ka qenë ni, e organizime prej studentëve sigurisht, por ajo është organizue ma shumë për çështje të ushqimit, për kushte edhe pa e ditë se ajo do të zgjatet pastaj do të bahet, do të përsëritet ta zëmë me 26 mars e me 2 prill. Me 1 prill unë nuk kam pasë ndonjë aktivitet.

Me 26 mars unë kam dalë në Ferizaj te, e kam shtjellu edhe ni shkrim e kam pasë, kam dalë në Ferizaj jam taku me kolegët gazetarë edhe njëri prej tyre tha, “Ishin shpërthyer në Prishtinë demonstratat”. “Çka? Qysh? Tek?” Kështu, kështu, thotë, “Studentët përsëri kanë dalë, kanë dalë në demonstrata”. Atyne shokve ju thashë, “Unë jom nisë për Prishtinë”, se nuk mujsha me ju thanë po shkoj në demonstratë, po, “Jom nisë për Prishtinë e kom një kështu ashtu...” ju shpjegova ni, e konstruktova ni arsyetim edhe u nisa drejt për Prishtinë.

Kur erdha në Prishtinë hyna në Pallat të Shtypit, te “Rilindja” nuk kishte diçka. Kur dola njëri prej tyre, ni kolegj gazetar ia nisi me më shoqnu edhe ishte i dyshimtë që ai po don me ditë ku po shkoj, çka po boj. Më shoqnoi. Ishte Dita e Shtafetës, ardhke shtafeta. Atëherë kur ardhke shtafeta u organizojke tubim i madh në Prishtinë. U organizonte te teatri, shkalltë e teatrit edhe deri aty unë shkova për me humb gjurmë se unë po shkoj në atë tubimin e shtafetës të Titos. Kur shkova aty u përzhdrodha nëpër turmë edhe i ika atij. Nuk u pashë ma me të edhe shkova. U nisa për me shku te qendra e studentëve.

Në rrugë e sipër po i shoh ato kompanjollat i qujshin atëherë. Ishin mushë me studentë edhe dhjetra të tillë i bajshin studentët me i çu në burg. Jam kthy tani prej aty. Me 1 prill tani kam marrë pjesë në demonstrata. Ka qenë demonstratë shumë e madhe. Është mbajtë ni tubim i madh aty para, tash, ku osht’ kjo, ku osht’ Ministria e Kulturës, aty osht’ majtë. Ka hypë Hydajeti në bli, ka majtë ni fjalim. Unë kam qenë në rranjë të atij blinit ku asht... bile kam qenë i armatosur me revole. Na kanë shpërnda, mas nja ni ore apo s’di sa ka zgjatë. Kanë, na kanë mshu me të gjitha mënyrat me krejt, na kanë shpërnda.

Anita Susuri: Me armë apo me...

Berat Luzha: Jo, kështu.

Anita Susuri: Me gazlotsjellës?

Berat Luzha: Me gazlotsjellës edhe policia na ka ndjekë. Tani jemi taku me Hydajetin atë natë. Kemi pasë vendin e caktum ku mund të takohemi diku jashtë qytetit. Ekemi bujtë, tani të nesërmen përsëri kemi shku. Unë kom shku vet në demonstratë se na humbi, s'mujshim ma, nuk ka pasë ni organizim sikur ishte me 1 prill po kanë qenë të ndame vende vende. Mu tani më kanë zanë në rrugë policia. Më kanë zanë me revole edhe më kanë rrah deri diçka tepër shumë. Më kanë çu në burg, më kanë burgosë, më kanë majtë dy muj. Hetime, tortura e të gjitha ato, por nuk u zbulu kurgjo te unë. Edhe ato dy muj ditë që më mbajtën në hetime m'i llogaritën për mbajtje pa leje të revolës. Dola prej burgut.

Anita Susuri: Keni qenë në Prishtinë ktu?

Berat Luzha: Në Prishtinë, po. Pastaj, kur osht' zbulu grupi në dhjetor të '81-tës kom ra përsëri në burg.

Anita Susuri: E po më intereson, në kohën kur keni qenë dy muj a keni pasë tani pasoja në punë? A keni vazhdu punën?

Berat Luzha: Po, gjatë sa isha në burg osht' majtë ni tubim me punëtorë, me gazetarë. Aty kanë marrë pjesë edhe prej Komitetit të Lidhjes Komuniste edhe m'kanë përmend aty si rast. Se filani është zënë bile është zanë me armë, a me s'di çka. Qishtu.

Anita Susuri: Ju kanë diferencu që thojshin atëherë?

Berat Luzha: Po, diferencu po se po. Ma s'pari (qeshë) m'patën përjashtu prej punës. Ni kohë tani, se unë u arsyetova që mu m'zunë vetëm për ni revole, asgja tjetër, se nuk isha në demonstratë hiç. Edhe ata më kthynë në punë, po tani nuk... më kthynë formalisht, por nuk më lajshin me punu se derisa të sqarohemi se çka është puna me ty. Edhe ajo zgjati diku gjashtë muj ditë ajo gjendje e imja as në punë as pa punë. Ma dhashin ni gjysë rroge. Kur rashë tani herën e dytë ma u bo ajo që u dënum, unë u dënova me dymdhetë vjet.

Anita Susuri: A ju kanë burgosë në shpi apo si ka ndodhë burgosja?

Berat Luzha: Burgosja në dhjetor osht' bo në shpi, në shpi po.

Anita Susuri: A e keni pritë?

Berat Luzha: Nuk e kom pritë se unë ende nuk e kam ditë që kanë ra shoktë tjerë në burg. Prandaj, nuk e kom marrë shumë me siklet, se mendojsha që veç mu a kumeditë ka ndryshu diçka edhe më kanë

marrë po më çojnë në pyetje anej knej. Se e kisha unë ni përvojë dy muj ditë që kisha nejtë edhe menojsa që po dyshojnë ashtu kshtu. Po kur shkova tani u pa që krejt grupi ishte i arrestum.

Anita Susuri: Sigurisht prapë keni qenë në Prishtinë derisa i kanë zhvillu hetimet. Sa kanë qenë hetimet? Sa kanë vazhdu?

Berat Luzha: Hetimet kanë qenë diku dhjetor deri kah prilli, katër muj qashtu.

Anita Susuri: A ka pasë nonstop dhunë fizike ndaj juve?

Berat Luzha: Herën e parë kur kom ra, ato dy muj ditë që jom dënue për demonstrata apo për armë pa leje atëherë m'kanë pasë rrah. Por herën e dytë jo, për shkak se grupi [ishte arrestu i tëri]... shkoi t'u zhvillu situata edhe nuk kishin nevojë me nxjerrë...

Anita Susuri: Informata.

Berat Luzha: Informata se ato informata ishin veç, veç ishin përpunu bukur shumë. Unë nuk e di, dy vet kanë qenë të lidhun me mu krejt me të cilët unë jom ngarku.

Anita Susuri: E në gjykatë kur keni dalë, sa keni qenë grup i madh? Edhe si ju ka ndiku çfarë vendimi me marrë?

Berat Luzha: Grupi është dënu në dy grupe. Në Prishtinë 19 vet kanë qenë dhe 16 në Gjilan që janë dënu, po kemi qenë ni grup të gjithë.

Anita Susuri: Kush ka pasë, për shembull që ka qenë ma i dënum që ka pasë vite ma shumë?

Berat Luzha: Ma i dënum ka qenë Hydajeti. Hydajeti tani ka pasë edhe tortura të rana edhe ka pasë edhe gjendjen shëndetësore të rëndume shumë. E kanë largu prej Prishtinës e kanë çue në mënyra të ndryshme andej e këndej nëpër hetime, nëpër vende të ndryshme.

Anita Susuri: Juve, sa ju kanë dënu?

Berat Luzha: Unë dymdhetë vjet kam qenë i dënum, nantë vjet i kom majtë.

Anita Susuri: Keni qenë në burg, në cilin burg keni shku fillimisht?

Berat Luzha: Fillimisht në Burgun e Qarkut ktu në Prishtinë. Masi jemi dënu, kemi marrë vendimin, më kanë çu në Mitrovicë me majtë burgun, në Burgun e Qarkut në Mitrovicë. Po aty pastaj patëm bo ni grevë urie, patëm bo edhe problem bukur shumë me rrapllimë të, të, rrapllima me dyrë e me sende të

ndryshme edhe tani më kthynë prapë në Prishtinë. Në Prishtinë më mbajtën edhe pak muj edhe më çunë në Nish. Në Nish e kam majtë burgun.

Anita Susuri: E ktu burgu në Prishtinë ose i Mitrovicës, çfarë burgje kanë qenë për shembull? Çfarë qelia keni pasë? Qysh kanë qenë kushtet? Po mendoj sigurisht kanë qenë të tmerrshme po...

Berat Luzha: Në krahasim me tash kanë qenë shumë të vështira. Ma s'pari nuk ka pasë WC, është dashtë me prit rendi kur të vjen për me dalë në WC se ka qenë e përbashkët për shumë dhoma ajo. Pastaj, nuk ka pasë krevata, nuk ka pasë higjienë. Ka pasë shumë probleme, ka pasë shumë njerëz me një dhomë, kushte s'ka pasë fare.

Anita Susuri: Ju keni qenë edhe me ni kohë po m'duket që ka pasë ma së shumti të burgosun politik...

Berat Luzha: Po, shumë ka pasë.

Anita Susuri: Për shkak të demonstratave. Sa veta, për shembull kanë qenë në qeli?

Berat Luzha: Deri, ni qeli ku kanë mujtë me, në suaza normale dy vetë me qenë kanë qenë shtatë a tetë, pesë, gjashtë, shtatë, tetë kanë qenë.

Anita Susuri: Çfarë rregulla ka pasë, për shembull mrena burgut?

Berat Luzha: S'pari kushtet kanë qenë shumë të vështira, ushqimi ka qenë shumë i dobët. Bukë fillimisht ka pasë, bukë me, ni gjysë buke, ajo bukë nuk ka qenë kilogramëshe, po ka qenë diku 600 gramëshe. Ni gjysë buke për 24 orë e kanë dhanë edhe ka pasë njeri që përneherë e ka hangër atë 600 gramëshe dhe ma nuk kanë pasë çka. Domethonë, njerëzit kanë duru uni për shkak se nuk janë, nuk ka mjaftu ushqimi. Edhe ai ushqim ka qenë shumë i dobët.

Anita Susuri: A keni qenë n'qeli edhe me ish të burgosun tjerë apo ju kanë nda?

Berat Luzha: Edhe me tjerë, po se kryesisht kanë qenë të burgosur politik atëherë, se ka pasë shumë të burgosur politik, por ka pasë edhe për vepra tjera. Ktu sa ishim në Prishtinë kemi shku mirë me ata që kanë qenë nëpër dhoma. Po kur kemi shku tani në Nish, unë në Nish e kam majtë burgun kryesisht, atëherë kemi pasë shumë problem. Për shkak se na kanë provoku, na kanë futë njerëz që kanë qenë të porositur kundër neve, me vepru kundër neve. Po edhe kemi pasë probleme shumë po kemi, megjithatë kemi pasë ni organizim si të burgosur, nifarë lloj uniteti të brendshëm. Kemi sakrifiku për njani-tjetrin e kështu.

Anita Susuri: E kur ju kanë dënu fillimisht, qysh ka ardhë deri te, domethonë vendimi? A ju kanë dhanë ndonjë dokument që keni me u transferu apo vetëm ju kanë marrë ju kanë çu? Qysh e keni ditë këtë?

Berat Luzha: Veç na kanë marrë, “Hajde bonu gati merri sendet e tua”, edhe na kanë futë nëpër ato marisa i qujshin përpara. Na kanë çu në Nish, nëpër burgje të Serbisë e të Jugosllavisë. Jo veç të Serbisë, por nëpër krejt Jugosllavinë deri në Slloveni.

Anita Susuri: A e keni ditë ju, për shembull, që po ju depërtojnë...

Berat Luzha: Jo, jo. Nuk kemi ditë kurgjo hiç. Mue ma s’pari më kanë çu në Pozharevc. Po më kanë çu disi si gabimisht edhe masi kam nejtë nja dy orë në Pozharevc kanë ardhë më kanë marrë edhe më kanë kthy në Nish. Në Nish tani e kam majtë burgun gati deri në fund.

Anita Susuri: Nantë vite apo?

Berat Luzha: Po, nantë vite bashkë me kto në Prishtinë që kam qenë.

Anita Susuri: Po më intereson tash edhe pjesa e familjes të juj. Ju, n’atë kohë jeni sigurisht keni pasë edhe familje, gru, bashkëshorte, fëmi.

Berat Luzha: Po, pra.

Anita Susuri: Qysh ka qenë gjendja e tyre? Si janë ballafaqu ata me këtë?

Berat Luzha: S’pari unë kam gjashtë fëmi. Atëherë katër i kom pasë në shpi edhe gruja ka qenë shtatzanë, fëmija i pestë. Gjendja edhe ashtu ka qenë e vështirë sikur të gjitha familjet tjera. Po kur jam burgosë unë tani nuk kanë pasë çka. Gruja ka qenë... pak vite që jemi martue, por shtatë-tetë vite po më duket që jemi martu i kemi pasë katër fëmi, të pestin edhe (buzëqeshë)...

[Pjesët në vijim të intervistës janë realizuar më 14 qershor, 2022]

Pjesa e Tretë

Anita Susuri: Zotni Berat, ishim t’u bisedu herën e kalume për jetën e juj edhe arritëm deri te burgosja, folëm pak edhe për burgun edhe mbetëm te familja. Ju më tregutë që bashkëshortja juj ka qenë shtatzanë sa jeni burgosë ju edhe deshtët me vazhdu me këtë periudhën edhe një kujtim që e keni lidhur me këtë.

Berat Luzha: Po. Fëmija i pestë me radhë lindi pas burgosjes sime dhe e sollën në vizitë në Burgun e Qarkut të Prishtinës, ku atje vizitat u bojshin përmes grilave. Grilat ishin aq të shpeshta sa që vështirë u shihte fytyra e personit nga ana e kundërt. Unë kërkova nga gardianët që të më lejojnë që të përqafoj fëmijën e porsalindur, mirëpo jo, në asni mënyrë. Qëndronte një nga Sekretariati i Punëve të Brendshme, i UBD-së i thojmë ne shkurtë dhe ai nuk lejoi. Kështu që mbeta pa e përqaflu. Tek mas shumë kohe në burgun e Nishit kam arritë që ta shoh fëmiun tim.

Anita Susuri: A është rritë ai fëmi? Se ai fëmi është rritë sa keni qenë ju nëburg, domethonë nantë vite. A ju ka njoftë ai? A keni pasë kontakt të shpeshtë?

Berat Luzha: Jo, s’kemi pasë se në Nish vizitat kanë qenë të rralla shumë, fëmitë të vegjël zakonisht prindërit nuk merrnin me vete. Nuk e di, ni herë a dy që ka qenë në Nish. Tek kur jom liru ajo i ka pasë dikund, dikund tetë vjet, tetë vjeçar.

Anita Susuri: Po m’intereson edhe me bisedu më duket edhe për ekonominë e familjes, si ka mbetë familja pasi ju nuk keni punu ma? Nuk ka pasë të ardhura prej juve, a i keni pasë fëmitë te prindërit?

Berat Luzha: Familjen e kom lanë shumë keq në gjendje të vështirë ekonomike pa krahë pune. Prindërit kanë qenë të vjetrum, pleq mbi 70 vjeç janë konë, kah 75 vjeçar te dytë me sëmundje me ato që i kanë pleqt zakonisht. Gruja që ka qenë nuse e re, po që ka qenë me pesë fëmi. Tashti gruja është detyru me punu edhe në shpi edhe në ara edhe të gjitha me u kujdes për fëmitë. Unë niherë i pata thanë në burg që tash edhe jom pendu që i kam thanë se ajo u fye. Thashë, “Fati ishte i tillë, por ti je e lirë mundësh me zgjedhë ni fat tjetër”. Mirëpo, ajo u fye tha, “Në asni mënyrë, as nuk e du”, thotë, “pse po ta zen goja me më thanë ashtu?” Edhe kështu.

Anita Susuri: Edhe juve sigurisht ju ka ardhë rond po...

Berat Luzha: Sigurisht po, po jashtëzakonisht.

Anita Susuri: Qysh ka qenë për shembull situata me familjen edhe me të afërmit? A ka pasë edhe prej tyne për shembull gjykime ose frikë me u taku me kta ose me ndihmu familjes të juv?

Berat Luzha: Ka pasë që i ka ndihmue, ka pasë nga miqtë e familjes e gruas, ka pasë nga fqinjët aty, ndonjë i rrallë se jo gjithkush. Ka pasë edhe nga fshati shokë të babës që kanë qenë, i kanë çu fëmitë e vet thotë, “Shko lavroje arën bacës Selman”. Edhe kështu nga pak kanë ndihmue. Por, megjithatë ndihma nuk zgjedh probleme.

Anita Susuri: Po më intereson tash, sa keni qenë në burg, osht' ni shprehje që ka burg ma të keq, s'ka burg të mirë po osht' njo që veçohet ma i keq. Cili ka qenë për juve periudha ma e vështirë? Në cilin burg edhe pse?

Berat Luzha: S'pari personi që burgoset ai në një mënyrë pajtohet me fatin e vet edhe nuk e çan kokën fortë se ku ndodhet edhe pse ndodhet po hin e mban ashtu siç është. Burgu sigurisht më i vështirë është ai i Nishit, është me famë të keqe. Aty edhe ka pasë, sidomos, ndaj shqiptarëve trajtim jo njerëzor, trajtim diskriminues. Për shkak se Nishi është edhe ma afër Kosovës edhe kontaktet me shqiptarë kanë qenë ma të shpeshta. Kështu që, urrejtja ka qenë ma e madhe ndaj shqiptarëve dhe ajo është shpreh pastaj në trajtimin tonë si të burgosur politik.

Ne edhe ashtu kemi qenë kryelartë nuk jemi nënshtruar. Kemi qëndruar stoik, kemi kundërshtuar shpesh organet e burgut, kemi bo greva urie. Kto grevat urie kanë qenë sikur protesta që zhvillohen në mënyrë ma të ashpër për ata se shfaqej paknaqësia jonë. Edhe ajo pakënaqësi pastaj transmetohej edhe në suaza të organeve të ndryshme të shtetit e më tej.

Anita Susuri: Për shembull, për çka keni bo grevë? A për me ndalu dhunën? A keni pasë naj kërkesë?

Berat Luzha: Një nga kërkesat ka qenë që neve të na kthejnë në burgjet në Kosovë, jo të na lirojnë prej burgut po të na kthejnë në burgjet në Kosovë. Atëherë flitej se burgu i Dubravës është ndërtuar edhe ne kishim dëshirë që të vijmë në Kosovë që të ikim prej Nishit ku kishim trajtim të keq. Po ka pasë edhe raste kur për padrejtësinë që u bojshin të burgosurve politik, qoftë ni individit prej neve solidarizoheshim pastaj të gjithë edhe e refuzojshim ushqimin të gjithë përnihërë.

Kjo pastaj shkaktonte reagimin e organeve të burgut, qoftë me tortura që na bojshin, qoftë me heqjen edhe atyne pak të drejta që i kishim. Ta zëmë na ndalojshin vizitat edhe ato ishin niherë në mujtë edhe po ta anulojshin ni vizitë domethonë ishte punë e madhe. Por, megjithatë, ne ishim që nuk pyetshim për pasojat por kishim dëshirë, kishim kërkesat tona me çdo kusht edhe i bojshim ato pa ngurrim.

Anita Susuri: E grevë urie që keni mbajtur, a ju kujtohet cila ka qenë ma e gjata edhe kur?

Berat Luzha: Ka qenë viti 1984, ka qenë 11 marsi. 11 marsi ishte dita e shpërthimit të demonstratave të vitit 1981 në Kosovë, ishte tre vjetori. Edhe në Kosovë në nifarë mënyre shënohej kjo ditë me protesta, me demonstrata, sado të vogla që ishin por shënohej. Edhe ne kishim dëshirë që ta shënojmë. Si ta shënojmë? Ta refuzojmë ushqimin. Edhe e refuzojshim ushqimin kolektivisht. Ndoshta kanë qenë dikund rreth 30 vetë që e kemi refuzu ushqimin në shenjë të solidaritetit të demonstratave të vitit '81.

Anita Susuri: A e dini afërsisht, veç kështu po pyes nuk është problem nëse nuk e dini, në kohën sa keni qenë ju në Nish edhe sa shqiptarë tjerë kanë qenë të burgosur politikë?

Berat Luzha: Po ata kanë ardhë e kanë shkue, por dikund deri në 50 vetë ka pasë të burgosur politikë. Plus që ka pasë edhe kta me veprat tjera penale, por që na u kanë bashkangjitë grupit të të burgosurve politikë. Ata kanë qëndru me neve, janë solidarizu me neve. Kanë nejtë, kemi nda të mirën e të keqën me ta.

Anita Susuri: Qysh ka qenë, domethonë organizimi i ditës në Burgun e Nishit? Qysh ka qenë ni ditë e juja për shembull?

Berat Luzha: Edhe pse në burg, ne megjithatë organizojshim jetën qoftë duke lexuar. Se kishte ni bibliotekë burgu ku mund të marrshim edhe pse ishin të përzgjedhur ato libra, nuk ishin ato që dëshirojshim ne. Mirëpo nga pak marrshim edhe nga shtëpia libra. Kishte... "Rilindja" na vinte edhe pse me vonesë dy-tri ditë, por na vinte. E lexojshim, e komentojshim, i përcillshim ngjarjet si po zhvillohen në Kosovë, i përcjellshim burgosjet në Kosovë. Nga njëra anë na vinte keq që po burgoseshin njerëzit nga ana tjetër na vinte mirë që po vazhdon rezistenca, po vazhdon lëvizja kombëtare nuk po shuhet.

Pastaj, ne i bojshim ndejat bashkarisht. U takojshim me... se aty kanë qenë disa pavione. Nuk ka qenë vetëm ni edhe nuk kemi pasë të drejtë me u taku me shokë të pavionit tjetër. Por ne bojshim mundime për me u taku me tjetër me shkëmby ni fjalë, me i dhanë kurajo tjetrit e kështu me radhë. E në këtë mënyrë ishte ni organizim, mund të thuhet, spontan por shumë i vlefshëm, shumë i vlefshëm. Saqë edhe grevat e urisë i bojshim së bashku edhe mundimet edhe sakrificat i bojshim bashkarisht.

Anita Susuri: E këto gazetatat që po thoni, "Rilindja", a ka ardhë ndonjëherë e cenzurume për shembull që e kanë hjekë ndonjë lajm a diçka?

Berat Luzha: Ndonjë rast ka pasë. Ndonjë rast po ose nuk vinte fare ose prehej.

Anita Susuri: Sigurisht kur ka pasë naj ngjarje?

Berat Luzha: Sigurisht. Diçka të rëndësishme ktu në Kosovë që është zhvillu.

Anita Susuri: E kto që po thuni, takimet e grupeve tjera, a ka qenë kjo diçka ilegale që keni bo brenda burgut apo si keni arritë?

Berat Luzha: Ishte ilegale pse nuk kishim të drejtë ne të kontaktojmë me shokë që ishin të pavioneve të tjera. Ato pavioni me pavion ndahej përmes murit, duvarit. Janë... kanë qenë të ndame me mur edhe ne s'kishim të drejtë. Mirëpo e shfrytëzojshim qoftë kur shkonim në drekë, në menzë, qoftë kur shkojshim në ndonjë, ndonjëherë na çojshin në kinema. Pastaj kur shkojshim në punë, në atë repartin industrial ka qenë ku punojshim ose kur ishim të mbyllur, se atje ka burg në burg. Kur ishte mbyllur

nëpër qelia kontaktojshim përmes dritares, përmes murit, përmes trokitjeve nga muri në mur. E kemi edhe këtë ni këngë shumë interesante është me tekst të Hydajet Hysenit.

Anita Susuri: E ka bo sa ka qenë në burg?

Berat Luzha: Po sa ka qenë në burg edhe kemi këndu edhe në burg, po.

Anita Susuri: A ka pasë tani pasoja kur keni knu apo diçka?

Berat Luzha: Zakonisht jo, se këndojsim kur ishim pak si ma të lirë, kur ishim në oborr, kur nuk kishte afër [gardianë]. Mirëpo, ndonjëherë edhe ka pasë, mund të ketë pasë se në dhoma kur ishim në qeli këndojsim bashkarisht edhe ndodhke që ardhke gardiani e hapte derën edhe na ndëshkonte.

Anita Susuri: E këto çfarë kangë kanë qenë? Sigurisht patriotike?

Berat Luzha: Po, sigurisht patriotike. Po kryesisht kanë qenë kangë të burgut që kanë përshkru jetën po edhe krenarinë tonë.

Anita Susuri: Që përmendet kinemanë që, ka qenë brenda burgut kinemaja?

Berat Luzha: Po, brenda burgut, po, po.

Anita Susuri: Ka qenë në sallë?

Berat Luzha: Ka qenë sallë ku jipeshin filma të ndryshëm. Nganjëherë edhe filma palidhje krejt, po, eh... se e kanë ata me ligj që ni lloj jete kinse kulturore, po.

Anita Susuri: Filma jugosllav kanë qenë apo?

Berat Luzha: Jugosllav, por edhe të huj ndonjëherë që nuk na interesojsin fare ata filma, por që e shfrytëzojsim rastin pastaj të takoheshim me shokë tonë edhe të kuvendojsim, të rrijsim, të shkëmbejsim mendime.

Anita Susuri: E qysh ka qenë, për shembull ushqimi?

Berat Luzha: E ushqim burgu, ushqim burgu i dobët shumë. Pastaj ne nuk jemi të mësuar me ushqim sikur janë ato me dhjam derri, ato të gjitha, të pregatituna jo mirë. Sasia e kufizme, ashtu, po mirë. Ktu në Prishtinë ka qenë ni rast, jo ni rast, por kur u burgosa në Burgun e Qarkut dhashin ni gjysëm buke për 24 orë. Por e dhashin në mëngjes, pastaj ti me u shërby me atë gjysë buke edhe për darkë edhe për drekë. Darkë e drekë edhe mëngjes gjysë buke edhe ajo gjysë buke ishte diku 300 apo 400 gram. Kishte

njeri që përneherë e hante atë bukë dhe gjatë gjithë ditës pastaj nuk kishte çka. Ishte vërtetë gjendje e urisë. Njerëzit ishin të untë gjithmonë.

Na patëm bo ni grevë urie. Më thirri zëvendësi, ka qenë zëvendës Sekretar i Jurispodencës atëherë quhej, ni Enver Nimani. Më thirri në raport, “Pse keni bo grevë?” Mes tjerash i tregova edhe për bukë, i tregova që njerëzit po vujnë për bukë. Osht’ sikur me qenë ni gjendje e urisë në burg. “Jo”, po tha, “s’osht’ e mundur”, “Osht’ e mundur”, edhe i tregoj që gjysë buke jipet për 24 orë. Ai tha, “Mirë”, tha, “do ta shikoj këtë punë”. Edhe të nesërmen kanë ardhë me karroca buka ka ardhë edhe të burgosurit kanë marrë sa kanë dashtë. Tri herë kanë marrë në ditë sa ju ka dashtë.

Anita Susuri: E familja a ka pasë të drejtë me sjellë diçka për juve ushqim? A ju kanë ndalu?

Berat Luzha: Ka pasë të drejtë, por ka qenë i kontrollum ushqimi. Ka pasë të drejtë. Ndonjëherë diçka që atyne nuk ju ka pëlqy e kanë kthy, nuk na kanë dhanë. Por kryesisht po. Po ka qenë e kufizume, nuk e di sa, ndoshta dy kilogram a s’di sa ka qenë krejt.

Anita Susuri: E për shembull librat që ju kanë sjellë, a kanë qenë edhe ato të kontrollume?

Berat Luzha: Jo, librat edhe ato të kontrollume, po ne kemi mujtë m’i marrë m’i lexu edhe kemi mujtë m’i kthy pastaj në vizitën tjetër.

Anita Susuri: Tash po më intereson, ju thatë që fillimisht ju kanë dhanë dymdhetë vjet burg më duket?

Berat Luzha: Po, dymdhetë jam dënu.

Anita Susuri: Po në cilin vit pastaj janë ulë këto vite, domethonë në nantë vite?

Berat Luzha: Në vitin 1990 kur fillunë këto ernat demokratike në Evropë. Rrximi i Murit të Berlinit, Bashkimi Sovjetik në Poloni ishin... edhe pastaj ajo u përhap edhe në Ballkan edhe në Jugosllavi. Edhe u hoq Neni 133 për propagandë armiqësore se për ni fjalë goje i merrshe pesë vjet, për shembull. Ai nen u hoq, mirëpo fillunë edhe të bojnë amnesti të burgosurve politikë se kishin presion prej botës që të burgosurve politikë të liroheshin atëherë. Pothuajse u patën liru të gjithë.

Deri në 1991-ten u patën liru të gjithë ata që ishin në mbajtje deri atëherë. Tani mas anej ka pasë të burgosur përsëri po ata që ishin u patën liru. Mu më ra që për 1 maj, për festën e 1 majit ma hoqën ni vit. Kur erdh tani festa e 29 nandorit atëherë u festonte si dita e Republikës së Jugosllavisë m’i hoqën edhe dy vjet. Kështu që, përfitova tri vjet amnisti dhe u lirova.

Anita Susuri: Qysh e keni pritë... a keni pritë që kanë me ju hjekë këto vite?

Berat Luzha: Jo (qeshë), në fakt nuk e kemi pritë. Jo se kemi pasë trajtimin rigoroz asisoji që ishim të rrezikshëm atëherë për shtetin. Mirëpo ishte presioni ndërkombëtar, jo veç në Jugosllavi por gjithkund që të liroheshin të burgosurit politikë.

Anita Susuri: A ka pasë për shembull vizita prej ktyne njerëzve ndërkombëtar apo diçka?

Berat Luzha: Ka pasë. Te ne ka qenë s'paku një delegacion i Kryqit të Kuq Ndërkombëtar. Ata na kanë marrë në pyetje, na kanë pytë për kushtet, për gjendjen të cilën ndodheshim e kështu. Jo diçka me rëndësi por një njoftim.

Anita Susuri: E sa ka mujtë me qenë ndikimi i ktyne në ndryshimin e ktyne kushteve?

Berat Luzha: Ndoshta ka ndiku pak, por jo, nuk osht' vrejtë shumë.

Anita Susuri: E ju e keni ditë saktë datën kur keni me dalë prej burgut apo jo?

Berat Luzha: Unë e kam ditë mas dymdhetë viteve.

Anita Susuri: Po.

Berat Luzha: Po, po erdh rasti që mas nantë vjetve. Ishte amnistia, e pata dëgju në radio se ato autoparlantat i vëjshin dhe lajmërojshin. Mirëpo, organet e burgut nuk e kanë shënu hiç këtë amnistinë teme edhe unë prit prit s'ka nuk vjen kush. Shkoj te ni edukator, u qujke, edhe po i them, "Po unë kom amnisti", them, "Qysh ti?" "I kallxova", e vërtetoi ai edhe më lshunë.

Anita Susuri: A ju kujtohet qysh keni shku prej Nishit deri në shpi? A e kanë ditë familjartë a qysh ka qenë qajo ditë?

Berat Luzha: Jo, nuk e kanë ditë familjartë. Është interesant ai udhëtim. Prej Nishit unë zgjedha me shku me tren, po tren nuk kishte për Prishtinë atëherë, por zgjedha me shku kah Shkupi, Nish-Shkup. Edhe prej Shkupit për Ferizaj se nuk ndalej gjithkund ai treni, "Akropolis" u qujke. Në Ferizaj mrriva diku në mesnatë, shkova diku te ni djalë mixhe e kisha në Ferizaj, bujta aty. Pastaj të nesërmen ai më mori, e gjetë ni veturë edhe shkum për në fshat. Tani ai djali i mixhës e ka lajmëru se Berati është në Ferizaj edhe tash po vjen. Atë ditë, jo ma herët nuk e kanë ditë.

Anita Susuri: Qysh ka qenë tani pritja?

Berat Luzha: Pritja ka qenë shumë e mirë. Me ni fshat fqinjë aty, Komogllavë, do miq, do dashmirë kishin dalë në rrugë, kishin bo ni pritje në rrugë me fjalime, me shumëçka tjetër. Pastaj në shpi ishin

pasë mbledhë në odë, e kemi ni odë të vjetër tash e kemi bo odë muze. Ishte mushë ajo oda plot. Pastaj, kështu me babën, me ata, nana u gzu.

Anita Susuri: E qysh ju dokë juve, domethonë mas nantë viteve me e pasë lirinë?

Berat Luzha: (qeshë) Po sigurisht mirë, megjithëse nuk ishim të knaqun se gjendja jashtë ishte e randë shumë. Pastaj kishim lanë shokë në burg. Ishim me shpirt të thym. Jo të knaqun se ndryshe është kur del në liri, po vërtetë je i lirë. Se unë edhe pas burgut pastaj kam pasë shumë herë arrestime. Diku dhetë arrestime gjatë shtatë-tetë viteve i kom pasë. Po ato nuk kanë zgjatë shumë, ama janë përcjellë me tortura, me kontrollime të shtëpisë, me marrje të materialeve e kështu.

Anita Susuri: E kjo ka ndodhë, a ka pasë ndonjë arsye pse apo veç kështu në mënyrë represioni?

Berat Luzha: Jo, se unë vazhdojsha veprimtarinë politike, vazhdojsha përmes LDK-së por që ata dyshojshin që unë kom edhe ma shumë lidhje sesa me LDK-në. Te të burgosurit politikë gjithmonë ata e shihshin rrezikun ma të madh. Kështu që më kishin në përcjellje edhe ni trajtim edhe sa isha në liri, ta zëmë, në thojza.

Anita Susuri: Viti '90-të ka qenë edhe, si me thanë, në dallim prej kohës kur ju jeni burgosë, në atë kohë kanë qenë demonstratat kanë përfundu, ka qenë kjo situata pak ma alarmante. Po edhe viti '90-të ka qenë, '89-ten kanë qenë do ngjarje që ndodhën demonstratat edhe greva e minatorëve...

Berat Luzha: Po.

Anita Susuri: Pastaj largimi i njerëzve prej punës, pastaj ka fillu fushata e Pajtimt të Gjaqeve. Qysh ka qenë krejt kjo periudhë? Krejt kto ngjarje qysh i keni përballu ju edhe qysh i keni përjetu?

Berat Luzha: Po në të gjitha si pjesëmarrës aktiv çdokund. Në ato Pajtimi i Gjaqeve është bo sa kam qenë në burg une, po masandej janë zhvillu edhe ngjarje tjera. Gjithmonë isha, se isha kyç meniherë në aktivitete politike. Isha edhe në fshat i kyçun edhe në komunë atje, pastaj edhe ktu në qendër. Isha, kam qenë deputet i kësaj legjislaturës '92-shës kur patëm bo do zgjedhje, ni kuvend që nuk e njohin kërkush e që nuk u bo shumë. Por që kishte simbolikën e vet.

Anita Susuri: E qysh ndodhi ai organizimi për qat' kuvend? A ka qenë rrezik për m'u organizu?

Berat Luzha: Ka qenë, sigurisht, po. Se gjithmonë përcjelljet ishin të aktivistëve. Unë thashë që isha veprimtar politik, isha kyç në LDK atëherë, isha në komunë një organ i përbashkët ka qenë, s'di si u qunte. Pastaj ni qeveri komunale kemi pasë formu atje. Pastaj ktu në Prishtinë e patëm bo, u bonë zgjedhjet, u bonë edhe deputetët edhe isha për, për organet e shtetit isha i rrezikshëm atëherë. Kështu që gjithmonë isha në cak të tyre për çdo gja pothuajse.

Na kanë arrestu në aktivitete edhe kanë ardhë në shpi na kanë arrestu edhe na kanë malltretu. Na kanë thirrë në biseda edhe pse nganjëherë nuk ju kam përgjigjë atyne bisedave. Kështu ishte ni jetë edhe pse jo në burg, por për mu ishte shumë e randë. Bile mund të them që ndoshta në ato vite të '90-ta isha nga më të përsekutimit ndoshta edhe në nivel të Kosovës, në atë periudhë '90, '97-'98.

Anita Susuri: E kto kur kanë ndodhë mbajtjet në burg, sa ju kanë mbajtë për shembull?

Berat Luzha: Nuk kanë mbajtë shumë, deri në katër ditë. Po ato katër ditë kanë qenë shumë të randa edhe me kërcënim edhe të likuidimit, "Se je i rrezikshëm ose zgjedh po të çojmë në Shqipëri ose zgjedh po të vrasim krejt se s'na vyn. Ti je kështu ti je ashtu..." Gjithmonë dyshojshin se kam lidhje me LPK-në, me shoktë në Zvicërr.

Anita Susuri: A keni dalë ju jashtë? Se shumica pasi kanë qenë kështu të persekutunë kanë dalë jashtë vendit.

Berat Luzha: Unë nuk kam dalë. Edhe pse kam qenë shumë i përndjekun, nuk kam dalë. Nuk më ka shku mendja asniherë që të iki, për shkak se nuk isha vet. Deri në '95-tën i kisha edhe pleqtë, i kisha edhe fëmijtë, por edhe nuk kisha dëshirë ta lëshoj vendin. Me gjithë ato që i kishim, megjithatë ma mirë të qëndrojsa këtu sesa të dalsha jashtë.

Pjesa e Katërt

Anita Susuri: Aktivitetin e keni vazhdu, thatë në politikë. Po cilat kanë qenë disa prej aktiviteteve ma konkrete që keni bo?

Berat Luzha: '96-ën e kemi formu këtë Shoqatën e të Burgosurve Politikë. Unë kom qenë themeluesi kryesor edhe kryetar. Atëherë ishte me rrezik të madh se tubimi i të burgosurve politikë ishte diçka që ju djetge shumë. Kështu që, megjithatë ne e bomë edhe patëm zhvillu aktivitet shumë të dendur. Edhe ishim në ndihmë të UÇK-së. Pothuajse krejt stafi i shoqatës, kryesia e shoqatës ka pasë dalë në luftë, ishte në shërbim të luftës të UÇK-së. Një rast dashtën të më arrestojnë. Erdhën aty te selia edhe diku rreth njëqind metra larg ishin stacionu edhe pritshin që unë të kaloj. Unë në fakt kisha kalu ma herët, kisha shku aty.

Po një nga shoktë që punonte në shoqatë më thotë që, "Janë stacionu", thotë, "policia edhe janë t'u na përcjellë neve". Atëherë e pashë që dojnë me më arrestu. Kam dalë ni sokaku tjetër andej jam sjellë bashkë me një që e kisha marrë si përcjellës, se atë ditë gjithë ditën më kanë përcjellë edhe ju ika. Pastaj kam qëndru rreth dhetë ditë në Prishtinë ilegal. Pa e ditë kërkush se ku ndodhëm përveç dy-tre shokve ndoshta. Kam shku herë te ni familje, te tjetra, te tjera. Në fund kanë ardhë do persona që kanë

qenë të angazhum në UÇK për logjistikë edhe ata më thanë, “A po don me dalë në Drenicë?” “Po”, thashë, “unë atë po e pres”. Edhe jemi marrë vesh jemi dalë msheftas krejt në, gjatë gjithë natës kemi udhëtue edhe kemi shku në Drenicë.

Anita Susuri: Kjo ka qenë viti ‘97?

Berat Luzha: ‘98, ‘98 ka qenë, korriku, fundi i korrikut.

Anita Susuri: Shoqata fillimisht sa anëtarë i ka pasë?

Berat Luzha: Asniherë nuk dihet numri i saktë po, po tashti llogaritet dikund dhetë mijë, njimdhetë mijë anëtarë të burgosur që kanë kalu nëpër burgjet serbe gjatë periudhës prej ‘45 e deri tash, deri ‘90-a, ‘98-ën, ‘99-ën. Mirëpo, një shumica e tyre kanë qenë në burgje të randa. Ka pasë edhe dikush, ka pasë për kundërvajtje me burgje ma të lehta, po kjo nuk do të thotë që ata kanë shpëtu lehtë se kanë pasë tortura. Por që burgun e kanë pasë ma të lehtë, ma të shkurtë. Sidoqoftë edhe sot e kësaj dite unë jom në atë komisionin për kompenzimin e të burgosurve politikë. Ky procesi i kompenzimit zgjatë diku prej 2015, 2014 a ‘15 ende vazhdon. Me mijëra njerëz tash po llogariten se kanë kalu nëpër burgje.

Anita Susuri: E ju thatë që keni pasë si aktivitet, si me thanë, me përkrahë luftën e UÇK-së, UÇK-në konkretisht...

Berat Luzha: Po.

Anita Susuri: Tjetër çfarë angazhimi ka pasë roli, organizata në atë kohë?

Berat Luzha: Ka pasë me ju ndihmu familjeve të burgosurve politikë edhe atyre që kanë qenë në burgje atëherë edhe familjeve që kanë qenë në gjendje të randë. Për shkak se të burgosurit politikë kryesisht kanë qenë në gjendje të vështirë ekonomike. Se burgu ka ndiku që ato të mbesin mrapa edhe sot e kësaj dite shumë familje të burgosurve politikë janë në gjendje, ndoshta edhe në gjendje kritike.

Anita Susuri: Po më duket për shkak se ata edhe kanë pasë problem edhe në atë kohë edhe shkollimin edhe punësimin.

Berat Luzha: Kanë hupë perspektivën, kanë humbur mundësinë e ekonomizimit.

Anita Susuri: Pasi që kalutë në Drenicë ‘98-ën, qysh ka vazhdu pastaj?

Berat Luzha: Në Drenicë kishte ardhë një makinë që shërbente për shtypjen e gazetave edhe UÇK-ja atëherë kishte pretendime me nxjerrë në gazetë atje në Drenicë. Unë atë ditë që u barta prej Prishtinës në Drenicë me një kombi, ai kombi çonte në Drenicë edhe rotoletë [që ishte] letër për shtypjen e

gazetave. Unë meniherë u kyça që të ndihmoj në hapjen e një redaksie apo një shtypshkronje për me u përgatitë për gazetë. Patëm siguru makinën, e rregullum, e çum në vendin e vet mirëpo në ndërkohë ndodhi një ofenzivë e forcave serbe edhe na u detyrum me dalë me ni anë tjetër të Drenicës edhe aty ma nuk pat mundësi me funksionalizu.

Në anën tjetër të Drenicës lajmërojnë që po vjen ni aparaturë e radios, me ba ni radio të luftës atje në Drenicë. Aty jemi angazhue pastaj dhe kam udhëheq atë hapjen e radios edhe të një agjencie të lajmeve. “Kosova Press” quhet edhe sot ekziston, te dyjat ekzistojnë edhe sot. Megjithëse sot janë... me përfundimin e luftës ato e kanë kry misionin e luftës, tash janë kështu ma shumë private.

Anita Susuri: Ka qenë “Radio Kosova e Lirë”?

Berat Luzha: Po.

Anita Susuri: Kjo ka qenë në Malet e Berishës apo?

Berat Luzha: Po.

Anita Susuri: E a më tregoni, për shembull çfarë kujtime keni lidhur me këtë periudhë? Edhe a ju ka ndodhë diçka që, sigurisht ka pasë vështirësi për me realizu atë?

Berat Luzha: Ka pasë vështirësi për shkak se s’pari media lokale nuk kishte, në ni odë të fshatit e kemi organizu aktivitetin krejt edhe funksionalizimin e dy mediave. Merre me mend me ni odë fshati. Pa pasë rrymë, me pak aparatura, me shumë pak patëm arritë me e ba edhe radion edhe agjencinë. Agjencia i dhake lajmet përmes internetit, radio transmetonte emisione. Mirëpo, kjo u pat bo problem se shtypi jugosllav, atëherë serb shkroi shumë ashpër për hapjen e ktyre mediave dhe vet ky Vuçiçi që tash është kryetar i Serbisë ka deklarë se, “Ato do t’i eliminojmë shumë shpejt”.

Në fakt, dy aeroplanë të Serbisë kanë fluturue mbi kokat tona, kanë gjujtë bomba, bomba kasetë i thojnë. Bomba që shpërndahen dikund, një bombë i ka më duket 60 bomba që i lshon e ato shpërndahen në sipërfaqe të madhe edhe çka rrokin ato e damtojnë, i shujnë krejt. Mirëpo për fatin tonë, fati i madh ishte që aeroplanët fluturun shumë ultë edhe nuk ishin preciz. Kështu që, dy aeroplanët, njëri i lëshoi bombat në lagjen ku ishim ne, tjetri i lëshoi në ni lagje pak ma larg për shkak se ata nuk e kanë ditë saktë në cilën lagje jemi edhe te dy lagjet i bombarduan. Në lagjen tonë shpëtunë krejt edhe pse kishte edhe njerëz të shpërngulur të ardhur prej fshatrave tjera të strehumë aty, por shpëtuan. Në lagjen tjetër ni familje ka psu randë. Një djalë 15 vjeçarë u vra, nja shtatë u plagosën, ishte gjendje shumë e randë.

Anita Susuri: Ju pastaj i keni gjetë këto bomba? Lokacionin?

Berat Luzha: Po se ato, ato bomba ni pjesë ishte toka e butë, ishin ngulë në tokë. Ato kasetat, ato arkat e kasetave, e bombave edhe ato kanë ra poshtë. Krejt ato u pajshin edhe i vizitum, i pamë.

Anita Susuri: E qysh ka qenë kur, domethonë, '99-ën kur NATO-ja filloi me ofanzivën e saj me bombardu Jugosllavinë? Ka qenë ni periudhë edhe kur osht' ashpërsu edhe ma shumë, domethonë sistemi jugosllav.

Berat Luzha: Po.

Anita Susuri: Qysh ka qenë kjo periudhë për juve? Edhe çfarë ndryshimi keni vrejtë?

Berat Luzha: Po pikërisht ky bombardimi i aeroplanëve ndodhi pikërisht atëherë kur u ashpërsu gjendja tejmase, shumë tejmase. Ni rast tjetër ka qenë kur na kanë gjujtë prej larg me kso farë raketa që shkojnë naltë, prej poshtë na gjujshin në kodër atje që të vrasin çka të mujnë. Patën bo të pamundshëm funksionimin e ktyne dy mediave dhe u detyrum që radion ta, të rregullojmë si një varr, t'i fusim ato aparaturën në varr edhe ta mbulojmë të duket sikur është varr i një njeriut. Kështu ka qëndru rreth ni javë. Kurse kjo "Kosova Pressi" është detyru me ndrru lokacionin, ka dalë ni odë tjetër edhe ka vazhdu me funksionu, me mbledhë lajme krejt ato.

Ni rast prapë na kanë gjujtë, mas ni kohe bukur të gjatë na kanë gjujtë në këtë odën tjetër edhe e kanë gjujtë shtëpinë e jo odën ku ne ishim. Shtëpinë e zotëve të odës. Po e kanë rrokë vetëm katin e sipërm të shtëpisë, e kanë shpu në dy antë. Mirëpo familja, anëtarët e familjes kanë qenë në katin e poshtëm edhe kanë shpëtu të gjithë. Kurse ne kemi vrapu çka u bo te ata, ata kanë vrapu te na mos na ndodhi neve diçka, familja.

Anita Susuri: Po më intereson a ka ndodhë ndonji, po mendoj, përmendet që ka ndodhë ni ofanzivë po ndonjë ofanzivë ku ka pasë pasoja edhe ju keni qenë prezentë? Pasoja në njerëz.

Berat Luzha: Jo se ne nuk ishim kështu drejtpërdrejt në...

Anita Susuri: S'ishit në kontakt shumë me njerëz.

Berat Luzha: Në kontakt të fronteve ose me i përcjellë kto. Ishim gjithmonë në kontakt përmes telefonit. Kishim njerëz me të cilët kontaktojshim në secilën strukturë të UÇK-së...

Anita Susuri: Për me marrë informacion sigurisht?

Berat Luzha: Për me marrë informacion të dorës të parë, po.

Anita Susuri: A keni pasë kontakte edhe me media të huja që keni përcjellë?

Berat Luzha: Kemi pasë, kemi pasë.

Anita Susuri: Cilat për shembull?

Berat Luzha: Po ta zëmë ka qenë ni radio austriake e cila mbante ni intervistë me mu, e përkthente aty për aty në gjuhën anglisht, gjermanisht, shqip ma une folsha edhe serbisht. Kam pasë kontakt me ni televizion turk TNT a TRT s’di si e qunte, ka qenë ni gazetare Burbuqe Rushiti, e jona ka qenë po atje ka punu. Ajo ka marrë shumë shpesh lajme, jemi lidhë me të për transmetimin e lajmeve edhe ajo drejtpërdrejt i transmetonte në turqisht lajmet. Po edhe mediat tjera, zakonisht kanë marrë informata. Po ajo që është me rëndësi ata i kanë marrë informatat prej faqes së internetit të “Kosova Pressit”, të agjencisë së lajmeve.

Anita Susuri: “Kosova Press” ka pasë atëherë faqe të internetit?

Berat Luzha: Posi. Atëherë është formu “Kosova Pressi”, agjencia e lajmeve “Kosova Press”. Unë e kam udhëheq atë. Ata kanë marrë edhe gazetari që ka qenë i “Kosova Pressit” ka qenë në Bruksel i stacionum. Ai drejtpërdrejt na ka informue se si po zhvillohet gjendja atje me NATO-në e me këto organet evropiane që funksionojshin atëherë.

Anita Susuri: Tekniken e këto si e keni siguru? Prej Evropës apo qysh kanë ardhë deri te ju?

Berat Luzha: Jo, teknika e radios ka ardhë nga një radio lokale që ka funksionu në Kumanovë, është qujtë Radio Kumanova, Radio Zëri i Kumanovës. Atje veprimtari që kanë qenë në Kumanovë kanë ra në kontakt me, ka qenë ni këngëtar Ismet Bexheti, keni ndëgju?

Anita Susuri: Po, po.

Berat Luzha: Radio ka qenë pronë e tij. Ai ka vendosë me mbyllë radion atje edhe janë marrë vesh që radion me sjellë për nevojat e UÇK-së. Dorë mas dore për ni kohë të gjatë ka ardhë nga fshati në fshat, nga vendi në vend edhe ka mrri atje. Atëherë tani janë thirrë ekspertë prej Prishtinës, disa që kanë ditë me instalue edhe e kemi funksionalizu edhe ka fillu me transmetu. Ka qenë 4 janari i vitit ‘99 kur kemi startu, kemi nisë me radion edhe me agjencinë.

Anita Susuri: Ju sigurisht keni zhvillu edhe intervista edhe me pjesëmarrës të UÇK-së...

Berat Luzha: Po pra, po pra.

Anita Susuri: A ka qenë, sigurisht që ka qenë vështirë me shku deri te ata ose me pasë komunikim me ta?

Berat Luzha: Ndonjëherë, se ata silleshin andej pari. Ta zëm shtabi i UÇK-së ishte atje, afër prej radios edhe agjencisë. Po, intervista bojshin edhe bashkëpunëtorët korrespondentë që i kishim në teren. Intervista bojshin edhe bashkëpunëtorët tanë që ishin në Bruksel, kemi pasë në New York bashkëpunëtorë, kemi pasë në Tiranë, në Prishtinë ktu në qytet kemi pasë e tjerë.

Anita Susuri: Sa ka qenë e vështirë me komunikuar në kushte lufte me tanë këta njerëz?

Berat Luzha: E vështirë ka qenë sigurisht. Kishim pos tjerash edhe problemin e rrymës, s’kishim rrymë. U dashke me punue me telefon satelitor ka qenë. Po ata punojshin me bateria, bateriat ku me i mbushë ishte problem. Ishim të detyrum ni veturë me e marrë, kishim në disponim ni veturë, njo prej anëtarëve tonë e kishte sjellë. E ndezshim veturën edhe e mushshim me rrymë baterinë e telefonit satelitor.

Anita Susuri: Tash unë nuk e di shumë, si me thanë, nuk kuptoj qaq shumë teknologji po kto valtë që i ka pasë radio e krejt valtë tjera a nuk ka qenë rrezik, për shembull, për aeroplanat me ju gjujtë ose me i kap ato signale?

Berat Luzha: Po ka qenë se ata i kapën edhe na gjujtën.

Anita Susuri: Kur ka ndodhë kjo që ju kanë gjujtë?

Berat Luzha: Ka ndodhë me 27 mars ‘99, tri ditë pasi kanë fillu bombardimet e NATO-së. Pasi kanë fillu bombardimet e NATO-së kta i kanë përgatitë dy aeroplanë, i kanë mbushë me bomba edhe i kanë zbrazë në selinë ose në odën ku ne qëndrojmë edhe ku ne punojshim.

Anita Susuri: A ka qenë dikush i pranishëm këtu?

Berat Luzha: Kemi qenë të gjithë, kemi qenë shumë po tashti stafi ka qenë shtatë-tetë vetë krejt po ishim aty. Fati ynë që ata nuk kishin, nuk ishin të saktë, kjo na shpëtoi. Përndryshe s’do të ishim tash në jetë.

Anita Susuri: E domethonë pak ma larg kanë gjujtë? Nuk kanë centru mirë?

Berat Luzha: Nuk e kanë, ata e kanë ditë vendin por ndoshta janë vonu për ni sekond edhe bombat kanë shku pak ma larg.

Anita Susuri: S’kanë qenë preciz.

Berat Luzha: Po pra. Kto janë punë sekondash.

Anita Susuri: E qysh erdh deri te ju lajmi që po shlirohet Kosova edhe që u kry lufta?

Berat Luzha: Po ne ishim në ngjarje se i përcjellshim ngjarjet, prej... t'u fillu prej Brukselit e krejt. E dishim çka po bohet. Po ne dikund me 17 qershor, me sa di, kemi zbritë, e kemi lëshu atje punën e kemi ardhë në Prishtinë, 17 qershor kur kishte katër-pesë ditë masi ishte shliro Kosova.

Anita Susuri: E po më intereson edhe familja juj ku ka qenë gjatë luftës?

Berat Luzha: Familja ka qëndru në fshat. Nuk ju ka dhanë mundësia me dalë në Maqedoni. Ashtu ka ndodhë që kanë, nuk kanë lëvizë fare por fati i tyne ka qenë që policia edhe trupat serbe s'kanë hy në fshat hiç, kjo ka qenë. Po pothuajse i tërë fshati ka qenë i shpërngulur, jo krejt, ni pjesë nuk janë shpërngulë. Po pjesa ma e madhe e fshatit ka qenë e shpërngulur nga frika se do të hyjnë edhe do t'na masakrojnë. Bile në Han të Elezit atje në pikën kufitare policët kur i kanë legjitimu njerëzit nga fshati im kanë pytë për familjen time, "Ku osht' familja e filan filanit?" Edhe ata kanë thanë, "Nuk e dijmë". Domethonë, nëse do të kishin lëvizë, do të kishin shkue ka pasë mundësi që atje t'i zanë edhe...

Anita Susuri: Fshati Begracë apo? Në cilën pjesë të Kosovës është më saktë? A është afër Maqedonisë?

Berat Luzha: Nuk është afër Maqedonisë, është në mes Kaçanikut, Ferizajit dhe Vitisë, mes ktyne tri komunave. Po nuk është larg Maqedonia prej aty.

Anita Susuri: Pasi keni ardhë që thatë në Prishtinë prej atyne Maleve të Berishës qysh ka qenë krejt rruga ky udhëtimi? Çfarë gjendje ka qenë Kosova? Çka keni pa ju?

Berat Luzha: S'pari unë kam ardhë me disa shokë që nuk ishin të agjencisë edhe të radios, por ishin të UÇK-së. Me ni veturë erdhëm, zbritëm në Ferizaj. Në Ferizaj i pam serbët që shpërnguleshin me të madhe, ikshin. Aty kishin dalë edhe shqiptarë plot ishte mush rruga, nifarë si manifestimi, ni gëzim i madh. Kemi vazhdue pastaj kemi shku në fshatin tim me pa a janë gjallë familja se...

Anita Susuri: S'keni pasë kontakt?

Berat Luzha: S'kisha as kontakt as lajme s'kishte. Asni lajm nuk kom mujtë me marrë prej familjes me muj të tanë. Shkova atje i gjeta shnosh të bom merak shumë. Kemi ardhë tani në Prishtinë prej katunit. Në Prishtinë ishte mush me njerëz që rruga isha mush me njerëz që ktheheshin prej Maqedonisë e prej Shqipërisë, ishte mush plot. Ishte mush edhe me tankse e mjete motorike të NATO-s që hynin në Kosovë. Po njëkohësisht ishte mush edhe me serbë që...

Anita Susuri: Që ikshin.

Berat Luzha: Që ikshin, që kishin mushë rrugën. Bile ktu në Çagllavicë ni kolonë e madhe me traktora, me vetura, me mjete të ndryshme ishte përskej rrugës, qëndronte aty. Si duket aty tani ata janë pendu dhe janë kthi përsëri në shtëpitë e veta, nuk kanë lëvizë ma shumë. Kur erdhëm në Prishtinë, Prishtina ishte krejt kto vitrinat e lokalet e thyme, të thyme kryesisht edhe të vjedhuna. Jo të djeguna, po ma shumë prej keqbërësve, kumeditë... po krejt të thyme.

Anita Susuri: Pastaj qysh ka vazhdu jeta ju? Po më doket nashta ka qenë ma lehtë, se shpijën nuk e keni pasë të dëmtune mesa kuptova?

Berat Luzha: Jo, jo, jo. Ka qenë ni shtëpi e vjetër edhe ashtu edhe me pasë damtu s'na kish kushtu shumë se ka qenë e vjetër e ashtu. Po unë jom gëzu ma shumë që ka shpëtu ni odë se osht' odë 200 vjeçare, odë e traditës shqiptare që tash e kom shndërru në muze.

Anita Susuri: E ju pastaj keni vazhdu aktivitetin e ju politik? Keni qenë deputet?

Berat Luzha: Po, po. Kom vazhdue. S'pari kam shku në "Rilindje", se "Rilindja" ka qenë mbyllë, ka pasë dhetë vjet që ka qenë e mbyllur. Dalke si gazetë me emrin "Bujku"...

Anita Susuri: Po.

Berat Luzha: Tani mas lufte meniherë e kthym emrin e gazetës edhe nxorrëm gazetën si "Rilindje: edhe unë isha në krye të "Rilindjes:. Masanej kur u bonë zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës isha kandidat, u bëra deputet. Tri mandate kam qenë deputet.

Anita Susuri: Cilat vite?

Berat Luzha: Prej 2001 deri në 2010. Tri mandate. Edhe ni mandat që ka qenë para luftës kështu, po.

Anita Susuri: Ju gjatë mandatit të ju osht' shpallë edhe Pavarësia e Kosovës.

Berat Luzha: Po, po.

Anita Susuri: Qysh e kujtoni qat' ditë?

Berat Luzha: Kam qenë nënshkrues i deklaratës, sigurisht që nga gëzimet ma të mdhaja të jetës. Po mirë, mirë. Ishte ni pjesë e realizimit të andrrave tona, po jo krejt se ne gjithmonë kemi pretendu edhe pretendojmë edhe sot e kësaj dite që trojet shqiptare duhet të bashkohen ashtu siç kanë qenë, ashtu siç i ka kriju natyra jo... se tash shqiptartë janë të ndamë në gjashtë shtete. Popull tragjik. Po me kohë besoj që gjanat do të vijnë në vend.

Anita Susuri: Po du me folë edhe për ni pjesë se osht' me rëndësi, pas luftës janë bo edhe disa komisione, nuk po di si t'i qujë, për lirim e të burgosurve që kanë mbetë nëpër burgjet serbe.

Berat Luzha: Po se ata që ishin në burgje që ishin në, burgosë gjatë viteve të '90-a po edhe gjatë luftës ishin ni pjesë të zanun peng ma shumë, të marrun rrugëve, nëpër shtëpia pa ndonjë faj të caktum po ishin marrë. Ata i transferunë prej burgut të Dubravës ku e bonë ni masakër shumë të randë, u vranë 120 vetë, të burgosur, të lidhur. Pastaj ata që shpëtun i dërgun nëpër Serbi nëpër gjithkrah edhe një rast ishte... ne kemi organizu, se unë isha edhe kryetar i Shoqatës të Burgosurve Politikë, ka qenë edhe Shukrije Rexha, nëse ke ndëgjue ka qenë sekretare e Shoqatës të Burgosurve Politikë.

E patëm kriju ni këshill për organizimin e protestave edhe kemi fillu me protesta. Prej meniherë mas lufte e deri pothuajse janë liru të gjithë. Por ni rast ka qenë kur të burgosurit serbë nëpër burgjet e Serbisë ishin rrebelue, kishin marrë në nifarë mënyre burgjet në dur të veta dhe u rrezikohej jeta të burgosurve politikë shqiptarë. Për shkak se dihet se në durë të kriminelëve ishin ra të burgosurit. Na organizum tani protesta të mdhaja ktu në Kosovë. Kto protesta në Prishtinë kanë qenë ndoshta me njiqind mijë vetë.

Kanë qenë ndoshta ma të mdhatë që njeh historia për protesta apo demonstrata. Shumë të mdhaja. Kanë ardhë nga të gjitha viset, kanë ardhë edhe në kamë ni pjesë. Po fati që patëm intervenu deri te Kushneri¹ drejtpërdrejtë. Kushneri në prezencën tonë kontaktoi me sekretarin e përgjithshëm të OKB-së, ka qenë Kofi Annan më duket atëherë edhe në nifarë mënyre u qetësu gjendja kadal kadale. Mas nja dhetë dite ma tepër u pa se nuk do të ketë viktima të të burgosurve shqiptarë dhe i ndalën protestat.

Anita Susuri: Domethonë ky aktivitet ka vazhdu sa kohë ka qenë?

Berat Luzha: Ka qenë dikund prej mas shlirimit deri në vitin 2000, ndoshta dy vjet.

Anita Susuri: Ju pasiqë jeni detyru nifarë forme me shkollimin me ndalë në atë kohë, me përfundu fakultetin po më duket, e keni vazhdu pas luftës...

Berat Luzha: Po, po, po, pas luftës.

Anita Susuri: Keni diplomu.

Berat Luzha: Po.

Anita Susuri: E përveç këtij angazhimit politik, a jeni marrë edhe me diçka tjetër?

¹ Bernard Kouchner ishte Ish-administrator i Kosovës nga vitit 1999 deri 2001. Ai ishte përfaqësues Special i Kombeve të Bashkuara i dërguar me mision në Kosovë si pjesë e UNMIK-ut.

Berat Luzha: Po (qeshë) nga pak unë shkruaj. Kom botu ni përmbledhje me poezi, libër poetik. Kom botu ni monografi për gjyshin e Afrim Zhitisë ka qenë edhe ai ni personalitet i Luftës së Dytë Botërore, i rëndësishëm. Kam përgatitë ose, po mirë, i kam përgatitë materialet e “Kosova Pressit”, agjencisë së “Kosova Pressit”. Gjatë lutës krejt ato informatat që janë plasur gjatë luftës edhe në agjencinë e lajmeve edhe në “Radio Kosova e Lirë” i kam përmbledhë në libra dhe kanë dalë katër vëllime të ni libri, në katër vëllime.

Anita Susuri: Ju më thatë që tash jeni në pension po jetoni edhe ndërmjet Prishtinës edhe fshatit, po du me ditë edhe pak tash për fëmijtë e ju, si janë? A e kanë zhvillu shkollimin? Në çka janë orientu?

Berat Luzha: Po, mund të them që prej gjashtëve që janë pesë kanë kry fakultet. Edhe jo shumë mirë të rahatun, deri dikund, deri dikund. Një prej fëmive, fëmiu ma i madh, djali, jeton në fshat. Ai punon në Komunë të Kaçanikut diçka po me ni rrogë shumë të ultë. Tjertë, i dyti është farmacist, ka hapë barnatore nifarë dore ashtu. I treti është angazhu edhe ai ashtu me të dytin. Vajza e dytë, se tri vajza e tre djem i kam. Vajza e dytë punon në Ministrinë e Punëve të Brendshme, sektorin civil. Vajza tjetër punon në Ministrinë e Arsimit, punon në sektorin e edukimit parashkollor.

Anita Susuri: Zotni Berat nëse keni edhe diçka me shtu për fund, nëse doni me cekë diçka që mendoni që është e vlefshme...

Berat Luzha: Nuk di, ju falënderoj për këtë bisedë.

Anita Susuri: Faleminderit juve.

Berat Luzha: Për mu është e mirë se ardhur jashtëzakonisht shumë.

Anita Susuri: Më vjen mirë që kemi bisedu.

Berat Luzha: Sepse pak kush interesohet tash për të kalumën tonë.

Anita Susuri: Është me rëndësi shumë.

Berat Luzha: Kurse edhe na shumë pak shkrujmë për të kalumën tonë.

Anita Susuri: Prandaj po m'vjen shumë mirë që bisedum. Faleminderit për kohën.

Berat Luzha: Faleminderit.